



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.213 dt.30.10.2000

**PER
MIRATIMIN E SHITESES SË LIMITIT TË PËRDORIMIT TË
TE ARDHURAVE PER BASHKINE E TIRANES PER VITIN 2000**

Këshilli i Bashkisë Tiranë, i mbledhur sot me dt.30.10.2000, pasi mori në shqyrtim relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Financës “Për miratimin e shtesës së limitit të përdorimit të të ardhurave për vitin 2000 dhe detajimin e tij sipas destinacioneve “, mbështetur në ligjin Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal”, ligjit Nr.8652, dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre,

V E N D O S I

1. Të miratojë shtesën e limitit të përdorimit të të ardhurave në masën 50.000.000 lekë nga të cilat 20.000.000 lekë për shpenzime operative dhe 30.000.000. lekë për investime, të detajuara si më poshtë :

1. Blerje paisje 10.000.000 lekë
(kompjutera, printera, telefona, fshesa me korrent, aparate faksi-etj, radio marrëse)

2. Blerje mjete transporti 10.000.000 lekë

3. Rikonstruksione 10.000.000 lekë
(rikonstruksion i Kabinetit)

4. Shpenzime operative 15.000.000 lekë
(kancelari, kostume pune për ndërmarrjet e vartësisë, vegla pune, etj)

5. Projekte kulturore 5.000.000 lekë
(festa e Tiranës dhe festa Kombëtare)

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendëshme dhe Drejtoria e Financës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

LEONIDHA TOSKA